



Prishtinë, 02 maj 2013
Kodi i ZRRE: V_530_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së); dhe
- Aplikacionin e KEK-OSSH-së të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE7) me dokumentacionin relevant sqarues.
- Vendimin nr. V_517_2013 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për OSSH;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e datës 16 prill 2013 për ngarkesa të rregullura të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

në seancën e mbajtur më 02 maj 2013 nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHEN** ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes që do të hyjnë në fuqi nga 1 prill 2013.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjetike e Kosovës SH.A. (KEK) kërkesën për shqyrtim të ngarkesës së rregullur të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes(DUOS);
 - o Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga ngarkesat e OSSH, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut, i lëshuar me datën 19 tetor 2012;
 - Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, i publikuar me datën 8 janar 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik , i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013.
- II. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



- III. Struktura e ngarkesave për OSSH, që do të zbatohet nga data 1 prill 2013 deri më 31 mars 2014 është si në tabelë e mëposhtme.

Niveli I tensionit	Elementi tarifor	Njësia	Tarifa
35kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€ cent/kWh	0.88
10kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€ cent/kWh	1.17
0.4kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€ cent/kWh	2.26

- IV. I licencuari duhet t'i publikojë ngarkesat e miratuara nga Bordi i ZRRE-së.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- VI. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar